

BURIMET JO PËRSËRITËSE E ENERGJISË

Qymyri, nafta, gazi (që njihen si karburante fosile) si dhe uraniami gjenden në grupin e burimeve jo përsëritëse të energjisë. Këto karburante i përdorim dhe harxhojmë më shpejtë sesa koha e cila u nevojitet që të krijohen në mënyrë natyrore. Pasoja e kësaj është se më herët ose më vonë ne do të mbesim pa to. Përdorimi i këtyre karburanteve përfundon, transportohen dhe përdoren, ato ndikojnë seriozisht ndaj ambientit jetësor.

Në centralët nukleare energjia fitohet me copëzimin e bërthamës së uranimit. Edhe përkundër se centralët nukleare nuk prodhojnë sulfur dyoksid, gjatë gjithë procesit të prodhimit të energjisë nga minimi deri te magazinimi i mbeturinave harxhohet shumë energji kështu që në këtë proces sasi të mëdha të gazrave qelqore lëshohen drejtpërdrejt në atmosferë. Mbeturit radioaktive mund të mbeten radioaktive një periudhë të gjatë edhe deri qindra ose mijëra vite, kështu që problemi me magazinimi i tyre ende nuk është zgjidhur.

Në elektranet termale, qymyri, nafta e papërpunuar dhe gazi natyror djegjin që të fitohet energjia elektrike. Gjatë djegjes së këtyre materialeve në atmosferë lëshohet karbon dyoksid, sulfur dyoksid, oksid azotik dhe tym. Sulfuri dyoksid dhe oksidi azotik shndërrohen në shirat atmosferike me çka shkaktojnë ndryshime kimike dhe zmadhojnë acidifikimi i tokës.

Elektranet dhe transporti (99% nga mjetet transportuese ende përdorin prodhimet e naftës) lëshojnë sasi të mëdha të karbonit dyoksid. Ai është shkak i kryesor për paraqitjen e efektit qelqor i cili shkakton rritjen e temperaturës mesatare në atmosferën e tokës me çka ndodhin ndryshime të mëdha klimatike në tërë botën.

Qymyri dhe uraniami nuk gërmohen vetëm nga thellësitat e kores (lëvores) së tokës, ndërsa edhe nga minierat sipërfaqësore. Përveç nga këndi estetik i pamjes ku shkatërrojnë ambientin jetësor, ata po ashtu ndotin edhe ujin, ndotin ajrin dhe shkaktojnë erozion të tokës.

Nafta e papërpunuar duhet të rafinohet që të mund të përdoret për automjetet. Nafta nuk është e rëndësishme vetëm si burim i energjisë, por ajo po ashtu përdoret edhe në industrinë kimike, si një substancë shtesë për shumë produkte. Rafineritë (si dhe minierat) mbajnë rreziqe të mëdha për ambientin jetësor.

Me siguri ne do të arrijmë të shohim fundin e përdorimit të naftës sepse rezervat botërore të naftës do të zgjasin për 20 deri 40 vitet e ardhshme, kurse gazi natyror do të harxhohet për 40 deri 50 vitet e ardhshme. Me përjashtimin e naftës së papërpunuar nga thellësitat dhe transportimi i saj deri te sipërfaqja dhe deri te kompanitë, shkaktohet ndotje të ujit që gjendet në thellësitat dhe rezervuarët sipërfaqësorë me ujë. Çdo vit, 200 mijë tonë naftë lëshohen në oqeanet dhe detet nëpër çarjet e rafinerive, porteve dhe terminalëve me anije transportuese të naftës - tankerë. Dredhja e naftës nëpër çarjet gjatë transportit të karburanteve përmes naftësllësisit si dhe gjatë transportit të gazit natyror në rezervuarët lëshohen gazra të dëmshme në atmosferë.

Nëse përdorimi botëror i këtyre materialeve mbetet i njëjtë, atëherë rezervat e qymyrit do të zgjasin për afërsisht edhe për 150 vitet e ardhshme, kurse rezervat e uranimit mbi do të mjaftohen në 50 vitet e ardhshme. Gërmimi i qymyrit dhe uranimit shkaktojnë ambientin jetësor. Minierat e thella ndotin burimet nëntokësore të ujit dhe kjo mund të shkaktojë ndotje të ujit të pijshëm dhe shembje të tokës. Pjesët e mbetura të gurit të papërdorur i cili lihet në gërmadha përreth minierave duket si një vrugë (shenjë) ndaj ambientit jetësor. Në rastin kur gërmohet uraniami, 90% e materialit që është gërmuar nga minierat është radioaktiv.